



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 247 Prot.

Tiranë, më 02.02. 2026

V E N D I M

Nr. 21, Datë 02.02. 2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 147 Regj., datë 24.06.2025, e paraqitur nga ankuesja znj. M.S , përfaqësuar nga Qendra për të Drejtat e Gruas Rome, përfaqësuar nga znj. M.V , Drejtore Ekzekutive kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjinisë”, “racës”, “etnisë”, “gjendjes ekonomike” dhe “gjendjes shoqërore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vijim Komisioneri),

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese, ndër të tjera informon se:

“Jetoj në Njësinë Administrative nr.11, ku kam ndërtuar në mënyrë informale një dhomë prej 15 m2. Këtë ndërtim e kam vetëdeklaruar pranë autoriteteve në datën 02.11.2006. Që nga ajo kohë, janë bërë dy matje nga institucionet përkatëse, hera e fundit në janar të vitit 2023 nga punonjësit R. M, pas ndërhyrjes dhe ndihmës së Qendrës për të Drejtat e Gruas Rome.

Megjithatë, edhe pas kësaj ndërhyrje dhe kryerjes së matjeve, procesi i legalizimit të banesës time nuk është përfunduar dhe nuk kam marrë asnjë përgjigje zyrtare nga ASHK. Në të njëjtën rrugë ku banoj unë, ndodhen edhe disa familje të tjera egjiptiane që ndodhen në të njëjtën situatë. Matjet për banesat e tyre janë kryer në të njëjtën periudhë me mua, por as ata nuk kanë marrë asnjë përgjigje.

Dua të theksoj se pjesa më e madhe e ndërtimeve informale të popullsisë jo rome në këtë rrugë janë legalizuar dhe kanë marrë dokumentacionin përkatës. Unë besoj se arsyeja kryesore pse procesi im nuk është përfunduar lidhet me faktin që jam një grua rome, e varfër dhe pa mbështetje

institucionale apo sociale. për pasojë, ndjej se jam diskriminuar për shkak të përkatësisë sime etnike dhe statusit tim shoqëror.”

Pala ankuese parashtroi gjithashtu se, ka jetuar për një periudhë të gjatë në kushte të rënda ekonomike dhe sociale. Ajo është nënë beqare dhe nuk ka pasur asnjë formë mbështetjeje institucionale. Gjatë gjithë kësaj kohe, ajo nuk ka përfituar nga programe sociale për strehim apo legalizim dhe nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të përballuar kostot e jetesës.

Sipas palës ankuese, kushtet e rënda ekonomike dhe sociale në të cilat ka jetuar së bashku me djalin e saj pasqyrohen qartë edhe nga kushtet e banesës ku ajo jeton. Sipas perceptimit të saj, përjashtimi i vazhdueshëm shoqëror për shkak të faktit që është grua rome, kryefamiljare dhe në kushte të thella varfërie, pa asnjë mbështetje institucionale, ka ndikuar drejtpërdrejt në zvarritjen dhe mosfinalizimin e procesit të legalizimit të banesës, që prej vetë deklarimit të ndërtimit informal në vitin 2006 e deri më sot.

Ankuesja ndjehet e diskriminuar edhe për shkak të gjinisë. Ajo është grua e vetme, pa asnjë përkrahje institucionale apo familjare, dhe përjeton vështirësi të theksuara në përballimin e një procesi administrativ të ndërlikuar. Nga përvoja e saj, burrat ose individët me mbështetje më të madhe sociale arrijnë më lehtë të përmbyllin me sukses procedurat.

Sipas informacioneve që ankuesja ka marrë nga banorët e zonës, një pjesë e konsiderueshme e ndërtimeve informale të kryera nga banorë që nuk i përkasin komunitetit rom janë legalizuar me sukses. Ajo përmend rastet e: F.D, E.K, M.K. Të gjithë këta persona, sipas saj, ndodhen në të njëjtën rrugë dhe kanë bërë vetë deklarimin në të njëjtën periudhë, por ndryshe nga ajo, kanë përfituar dokumentacionin përfundimtar të legalizimit.

Përfundimisht, pala ankuese kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe përfundimin e procesit të legalizimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës nr. 147, datë 24.06.2025, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 819/2 prot, datë 17.07.2025, Komisioneri njoftoi dhe kërkoi informacion në lidhje me ankesën nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Në lidhje me paraqitjen e kësaj ankese u informua edhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme. Në mungesë të

një përgjigje, me shkresën nr.818/6 prot datë 14.08.2025, Komisioneri ripërsëriti kërkesën për informacion drejtuar subjekteve.

2. Bazuar në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“ 8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”* për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, me shkresën nr. 819/5, prot datë 16.09.2025, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e një seancë dëgjimore publike në datën 25.09.2025.

Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të përfshira në procedurën administrative, ankueses M.S dhe përfaqësueses së saj znj. M.V , Drejtore Ekzekutive e Qendrës Për të Drejtat e Gruas Rome, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, përfaqësuar me autorizim nga z. J.B, me detyrë Specialist pranë Sektorit të Shërbimeve të Kadastrës dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme, përfaqësuar me autorizim nga z. G.M.

Gjatë seancës dëgjimore, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri (DVASHK), depozitoi shkresën nr. 8490/1 prot datë 24.09.2025, sipas të cilës rezulton se:

Pranë DVASHK Tiranë Veri administrohet praktika e legalizimit në emër të znj. M.Xh.S me nr. 5476 prot., datë 02.11.2006, ndodhur në njësinë administrative nr.11.

DVASHK, Tiranë Veri mori masa për verifikimin e rastit duke verifikuar gjendjen faktike në terren dhe më pas do të vijohet me shqyrtimin e dokumentacionit tekniko-ligjor.

Për sa i takon procedurave kualifikuese, do të vijohet sipas ligjit nr.20/20 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në republikën e Shqipërisë”* dhe akteve nënligjore në fuqi.

Gjatë seancës dëgjimore dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, palëve iu relatua mundësia e zgjidhjes së çështjes me pajtim.

3. Me e-mail-in e datës 22.01.2026, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, informoi Komisionerin se, ishte miratuar vendimi i legalizimit për ankuesen. Nga aktet e vendosura në dispozicion, rezulton se, me vendimin nr. 8651, datë 20.01.2026 *“Për Legalizimin e ndërtimit pa leje”*, të DVASHK Tiranë Veri, është vendosur: *“1. Legalizimin e ndërtimit pa leje, përfshirë në procedurat e legalizimit nëpërmjet aplikimit Nr .prot., 5476 datë 02.11.2006 me Numër Unik (INDEX): 12_2000641 në zonën kadastrale nr.8320 poseduar nga M.XhS.....”*

Në këto kushte dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, në kushtet kur palët kanë arritur në një marrëveshje midis tyre për zgjidhjen e çështjes objekt i ankesës objekt shqyrtimi, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin ka filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb dhe është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është iniciuar ankesa.

4. Me e-mailin e datës 28.01.2026, pala ankuese, nëpërmjet përfaqësueses së saj znj. M.V , Drejtore Ekzekutive e Qendrës Për të Drejtat e Gruas Rome, deklaroi tërheqjen nga ankesa sepse qëllimi i saj ishte arritur dhe ankueses i është lëshuar leja e legalizimit, duke kërkuar nga Komisioneri mbylljen e kësaj çështje.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”*

Në nenin 90, *“Përfundimi i procedurës administrative”*, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, sanksionohet se: *“3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrative.”*. Ndërsa, në nenin 94 *“Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”*, pika 1, të Kodit të procedurave Administrative, parashikohet si vijon: *“1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.*

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga pala ankuese, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës Nr. 147 regj, datë 26.06.2025, paraqitur nga ankuesja M.S kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin kishte filluar procedura hetimore dhe pala ankuese është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) dhe pika 3, nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 147 Regj., datë 24.06.2025, të paraqitur nga ankuesja M.S kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: “gjinia”, “raca”, “etnia”, “gjendje ekonomike”, “gjendje shoqërore”
Fusha: Të mira dhe shërbime
Lloji i vendimit: Arritje efektiviteti